

**Nëse jeni viktimë apo dyshoni  
se një person mund të jetë  
në rrezik trafikimi:**

**MOS HESHT!  
Raporto!**

### **Në Shqipëri**

- ♥ Telefono falas në mënyrë anonime në numrin **116 006** ose **112**;
- ♥ Dërgo SMS nëpërmjet Aplikacionit **“Raporto Shpëto”** duke e shkarkuar falas nga Google Play Store;
- ♥ Drejtohu tek **Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve** në çdo bashki.

### **Në Kosovë**

- ♥ Telefono falas në linjën ndihmëse në numrin **0800 11 11 2** ose **192**;
- ♥ Drejtohu në **stacionin policor** më të afërm apo **Qendrën për Punë Sociale**.



Republika e Kosovës  
Ministria e Punëve të Brendshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E PUNËVE  
TË BRENDSHME

**#BashkëMundemi!  
#NdalojmëTrafikimin!**

**TRAFIKIMI**

**I PERSONAVE  
ËSHTË**

**KRIM!**



HAPI SYTË



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijet në mbarë botën. tdh.ch

## Çfarë është trafikimi i personave (qenieve njerëzore)

Trafikimi i personave është krim dhe forma më e rëndë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Shfrytëzimi për trafikim bëhet në disa nga mënyrat e më poshtme:

- shfrytëzimin për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual;
- shfrytëzimin për punë;
- shfrytëzimin e fëmijëve dhe grave për lypje;
- martesat e detyruara;
- shfrytëzimin e fëmijëve apo të rriturve për kryerjen e krimeve, si: vjedhja, shpërndarja e drogës, etj;
- transplantimin e organeve etj.

## Treguesit që një person po trafikohet:

- Shihen shqetësime apo informon se është i/e abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar apo jep shenja se kërkon ndihmë;
- Ka shenja në trup që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;
- Kur një i mitur apo i rritur duket i lënë pas dore: është i keq ushqyer, i veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike, strehim i papërshtatshëm;
- Tregon për punën që bën dhe kushtet e punës nuk janë të përshtatshme për moshën e tij/saj;
- Udhëton apo gjendet në vende që nuk janë të përshtatshme për moshën e tij/saj dhe nuk ka ndonjë shpjegim pse gjendet aty;
- Fëmijët posedojnë gjëra me vlerë dhe nuk ka ndonjë shpjegim bindës;
- Fëmija apo i rritur është në shoqërinë e personit/ve që nuk janë familjar të tij/saj dhe gjatë gjithë kohës mbahet nën kontroll , etj.